



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

2999
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 89.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për miratimin e zbatimit të projektit LAKE-CARE – ‘Veprimi Komunitar për Restaurimin dhe Shëndetin e Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës’, si dhe miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar për realizimin e këtij projekti.”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2026

“PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT LAKE – CARE ‘VEPRIMI KOMUNITAR PËR RESTAURIMIN DHE SHËNDETIN E EKOSISTEMIT TË LIQENIT TË SHKODRËS’, SI DHE MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 84, DATË 18.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026–2028 TË BASHKISË SHKODËR", I NDRYSHUAR, PËR REALIZIMIN E KËTIJ PROJEKTI.

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____.____.2026, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Ligji nr. 87/2025, datë 12.12.2025 ‘Për buxhetin e vitit 2026, i ndryshuar; Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; ligjit nr. 47/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi kuadër për Kerkimin dhe Inovacionin”; si dhe Marrëveshjes së Grantit nr. 101157482, administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot. 19197/1, datë 23.07.2026, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. ____ prot., datë _____ të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë zbatimin e projektit *Lake – Care ‘Veprimi komunitar për restaurimin dhe shëndetin e ekosistemit të Liqenit të Shkodrës’*, financuar në kuadër të thirrjes EUROLakes Replication Call” si dhe shtesën e planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të

miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", për realizimin e këtij projekti.

2. Vlera totale e financimit nga donatori për Bashkinë Shkodër do të jetë **75,000 euro**, e konvertuar në lekë në shumën 7,066,125 Lekë, sipas kursit zyrtar 94.215 ALL marrë nga *Infor Euro* për muajin korrik 2026, kur është nënshkruar marrëveshja e grantit. Projekti financohet tërësisht nga donatori, ndërsa Bashkia mbulon detyrimin për TVSH-në që lidhet me zbatimin e tij. Projekti shtrin efektet financiare për 24 muaj, duke filluar nga 1 shtatori 2026 deri me 31 gusht 2028.

3. Nga vlera totale e financimit prej **75,000 euro**, e konvertuar në **7,066,125 lekë**, shuma prej **22,460 euro**, e konvertuar në **2,116,069 lekë**, përbën pjesë të buxhetit total të projektit dhe do t'i transferohet Institutit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Territorit (ETMI), për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit.

Kjo shumë do të përfshihet në fondet e financimit që do të kalojnë në llogarinë e Bashkisë Shkodër nga donatori dhe, pas marrjes së financimit, do t'i transferohet partnerit ETMI, në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit dhe procedurat financiare në fuqi.

4. Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të realizohet në dy këste: **80%** pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Bashkia Shkodër, në cilësinë e Partnerit Lider, dhe **20%** pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër merr përsipër të parashikojë në kërkesat buxhetore të PBA 2027–2029 shumën prej **988,127 lekë**, që përfaqëson këstin e dytë prej **20%** të vlerës prej **52,540 euro** e konvertuar në **4,950,056 lekë**, pa përfshirë vlerën e transfertës për ETMI, deri në momentin e akordimit të fondit.

5. Bashkia Shkodër do të financojë nga fondet e veta vlerën e TVSH-së që nuk mbulohet nga donatori. Për vitin 2026, detyrimi i TVSH-së, në vlerën **1,131 lekë**, do të mbulohet nga tepricat e fondeve të programit buxhetor **AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural"**, sipas fishës **PAC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale**, nën aktiviteti **A.1 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale**. Për periudhën e zbatimit të projektit 2027–2028, fondet për mbulimin e detyrimit të TVSH-së do të sigurohen dhe do të planifikohen në kuadër të kërkesave buxhetore të **PBA-së 2027–2029**.

Pakësime viti 2026:

në lekë

Nr.	Nr. Programi	Programi	Produkti	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.602 Shpenzime operative	Institucioni Likuidues
1.	AC141 Kap.5	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural	V476AAB	PAC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale A.1 Prodhim,	1,131	Bashkia Shkodër

				publikim dhe botim i materialeve promociionale.		
			Totali		1,131	

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin AC141 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural” P.AC141.Q3.O1.A3 Projekti LAKE-CARE dhe institucioni likuidues sipas fises: Bashkia Shkodër sipas detajimit:

Buxheti total në lekë nga donatori:

Shpenzimet e llogaritura NGA DONATORI						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga (600)	Siguri me shoq + Shënd (601)	Shpenzi me Operativ e (602)	Transferte (604)	Shpenzim e kapitale të trupëzuar a (231)
Shuma 2026	2,057,090	156,962	31,468	175,805	1,692,855	
Shuma 2027	4,140,372	392,405	78,670	560,202		3,109,095
Shuma 2028	868,663	235,443	47,202	162,804	423,214	
Shuma totale nga Donatori	7,066,125	784,810	157,340	898,811	2,116,069	3,109,095

Mbulimi i TVSH me burim financimi fondet e Bashkisë Shkodër në lekë (Shpenzime për TVSH për shpenzime operative dhe shpenzimeve kapitale)

	Shpenzimet e llogaritura TVSH		
	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	1,131	1,131	
Shuma 2027	651,214	29,395	621,819
Shuma 2028	3,392	3,392	
Shuma totale e mbulimit të TVSH me burim financimi fondet e Bashkisë Shkodër	655,737	33,918	621,819

Buxheti total në lek për t'u mbuluar nga donatori për Bashkinë Shkodër, pas zbritjes së transfertës së parashikuar.

Shpenzimet e llogaritura për Bashkinë Shkodër nga donator, pas zbritjes së transfertës së parashikuar.					
	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga (600)	Sigurime shoq + shënd (601)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	364,235	156,962	31,468	175,805	
Shuma 2027	4,140,372	392,405	78,670	560,202	3,109,095
Shuma 2028	445,449	235,443	47,202	162,804	
Shuma totale	4,950,056	784,810	157,340	898,811	3,109,095

6. Propozojmë miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë **942,150 lekë** për 1 (një) punonjës të planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2026 – 2028, për pozicionin Koordinator të projektit. Fondi i përllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori. Punonjësi do të angazhohet me kohë të plotë (100%), për një periudhë prej 10 muajsh, të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.

Emertimi	Punonjës	Arsim i lartë		Arsim i mesëm
		Grupi i diplomimit	Kategori	Klasa
Përgjegjës (Koordinator lokal të projektit – 10 muaj të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.)	1		III-2	


7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI



Zv. Kryetar



Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse




Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar



Drejtoria Juridike




Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor




Drejtoria e Financës




Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik




Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse




Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit



Drejtoria e Përgjithshme të Planifikimit dhe
Kontrollit të Territorit



Drejtoria e Turizmit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr. _____ prot.

Shkodër, me _____._____.2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT LAKE – CARE ‘VEPRIMI KOMUNITAR PËR RESTAURIMIN DHE SHËNDETIN E EKOSISTEMIT TË LIQENIT TË SHKODRËS’, SI DHE MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 84, DATË 18.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026–2028 TË BASHKISË SHKODËR", I NDRYSHUAR, PËR REALIZIMIN E KËTIJ PROJEKTI.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër është shpallur fituese në kuadër të thirrjes “Application Form EUROLakes Replication Call” me projektin “*Veprimi Komunitar për Restaurimin dhe Shëndetin e Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës*” Akronimi i projektit: *LAKE-CARE*.

Projekti synon restaurimin dhe përmirësimin e vlerave mjedisore, sociale dhe ekonomike të Liqenit të Shkodrës përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, komunitetit lokal dhe palëve të interesit, duke përdorur metodologjinë 4 Returns dhe zgjidhje të bazuara në natyrë (NBS). Metodologjia synon që projektet të krijojnë jo vetëm fitim financiar por katër lloje kthimesh (returns): *rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komunitetit, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve lokalë, restaurimin e kapitalit natyror dhe krijimin e përfitimeve ekonomike të qëndrueshme.*

Objektivat specifik të projektit janë:

- Themelimi i një Komuniteti Praktike (CoP) gjithëpërfshirës për menaxhim afatgjatë e të koordinuar të liqenit.
- Përmirësimi i cilësisë ujit. Vendosja e monitorimit të vazhdueshëm (12–15 herë/vit) dhe reduktimi i ndotjes.
- Restaurimi i habitateve, mbrojtja e zonave të folezimit dhe e biodiversitetit të shpendëve e peshqeve.
- Zgjidhje të bazuara në natyrë (eko-shtigje, ballkona vëzhgimi) që diversifikojnë të ardhurat lokale përmes eko-turizmit.

Projekti do të zbatohet në katër faza kryesore. Në fazën e parë do të identifikohen dhe angazhohen palët e interesit, do të krijohet Komuniteti i Praktikës (CoP) dhe do të nënshkruhet

Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim. Në fazën e dytë do të hartohet raporti bazë mbi gjendjen e Liqenit të Shkodrës, duke analizuar cilësinë e ujit, gjendjen e habitateve dhe potencialin për zhvillimin e ekoturizmit. Në fazën e tretë do të përgatitet udhërrëfyesi i veprimeve, i cili do të përcaktojë masat prioritare për restaurimin e ekosistemit, përmirësimin e cilësisë së ujit, zhvillimin e shtigjeve ekologjike dhe promovimin e biodiversitetit. Në fazën e katërt do të zbatohen ndërhyrjet pilot, të cilat përfshijnë aplikimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NbS) në rreth 500 m² të brigjeve të liqenit, ndërtimin e dy platformave për vëzhgimin e shpendëve, zhvillimin e 2 km shtigjeve ekologjike dhe monitorimin e ndikimit të këtyre ndërhyrjeve në cilësinë e ujit, biodiversitet dhe zhvillimin e ekoturizmit.

Në përfundim, do të organizohet një panair për promovimin e rezultateve të projektit, ndërhyrjeve të bazuara në natyrë (NBS) dhe produkteve lokale, duke rritur përfshirjen e komunitetit dhe promovimin e ekonomisë lokale.

Në tërësi, projekti synon të krijojë një model bashkëpunimi afatgjatë për menaxhimin e qëndrueshëm të Liqenit të Shkodrës, duke kombinuar mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e ekoturizmit dhe fuqizimin e komunitetit lokal.

Partnerët përfitues:

Bashkia Shkodër në cilësinë e liderit të projektit dhe Instituti për Menaxhimin Mjedisor dhe Territorial (ETMI) në cilësinë e nënkontraktorit të projektit.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 24 muaj dhe do të shtrijë efektet e tij financiare nga 1 shtatori 2026 deri me 31 gusht 2028. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër do të jetë 75,000 euro, e konvertuar në lekë në shumën 7,066,125 Lekë, sipas kursit zyrtar 94,215 ALL marrë nga *InforEuros* për muajin korrik 2026 (që përkon me muajin kur është nënshkruar Marrëveshja e grantit). Projekti financohet tërësisht nga donator, ndërsa Bashkia mbulon detyrimin për TVSH-në që lidhet me zbatimin e tij.

Nga vlera totale e financimit prej 75,000 euro, e konvertuar në 7,066,125 lekë, një pjesë e financimit, në vlerën 22,460 euro, e konvertuar në 2,116,069 lekë, do t'i transferohet, **Instituti të Menaxhimit të Mjedisit dhe Territorit (Environmental and Territorial Management Institute – ETMI)**, për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit.

Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas *Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare"*.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: **80%** e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Bashkia Shkodër si Partneri Lider dhe **20%** e buxhetit do të transferohet pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër merr përsipër të parashikojë në kërkesat buxhetore të PBA 2026–2028 shumën prej 988,127 lekë, që përfaqëson këstin e dytë prej 20% të vlerës prej 52,540 euro e konvertuar në 4,950,056 lekë, pa përfshirë vlerën e transfertës për ETMI. Në momentin e

miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të rimbursohet.

Gjithashtu Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma **655,737 lekë** për shpenzime operative si dhe shpenzimeve kapitale. Për vitin 2026, detyrimi i TVSH-së, në vlerën **1,131 lekë**, do të mbulohet nga tepricat e fondeve të programit buxhetor **AC141 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural”**, sipas fishës **PAC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promicionale**, nën aktiviteti **A.1 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promicionale**. Kjo për faktin se, për këtë fishë, më datë 27.08.2026 është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik dhe, pas angazhimit të fondeve për realizimin e kontratës, rezulton një tepricë fondesh e disponueshme.

Për periudhën e zbatimit të projektit 2027–2028, fondet për mbulimin e detyrimit të TVSH-së do të sigurohen dhe do të planifikohen në kuadër të kërkesave buxhetore të **PBA-së 2027–2029**.

Pakësime viti 2026:

në lekë

Nr.	Nr. Programi	Programi	Produkti	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.602 Shpenzime operative	Institucioni Likuidues
1.	AC141 Kap.5	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural	V476AAB	PAC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promicionale A.1 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promicionale.	1,131	Bashkia Shkodër
Totali					1,131	

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin ‘AC141 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural” sipas detajimit:

Buxheti total në lekë nga donatori:

Lekë

Shpenzimet e llogaritura NGA DONATORI						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga (600)	Sigurime shoq + Shënd (601)	Shpenzime Operative (602)	Transfertë (604)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	2,057,090	156,962	31,468	175,805	1,692,855	
Shuma 2027	4,140,372	392,405	78,670	560,202		3,109,095

Shuma 2028	868,663	235,443	47,202	162,804	423,214	
Shuma totale nga Donatori	7,066,125	784,810	157,340	898,811	2,116,069	3,109,095

Mbulimi i TVSH me burim financimi fondet e Bashkisë Shkodër në lekë (Shpenzime për TVSH për shpenzime operative dhe shpenzimeve kapitale)

Lekë

	Shpenzimet e llogaritura TVSH		
	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	1,131	1,131	
Shuma 2027	651,214	29,395	621,819
Shuma 2028	3,392	3,392	
Shuma totale e mbulimit të TVSH me burim financimi fondet e Bashkisë Shkodër	655,737	33,918	621,819

Buxheti total në lek për t'u mbuluar nga donatori për Bashkinë Shkodër, pas zbritjes së transfertës së parashikuar.

Lekë

Shpenzimet e llogaritura për Bashkinë Shkodër nga donator, pas zbritjes së transfertës së parashikuar.					
	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga (600)	Sigurime shoq + shënd (601)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	364,235	156,962	31,468	175,805	
Shuma 2027	4,140,372	392,405	78,670	560,202	3,109,095
Shuma 2028	445,449	235,443	47,202	162,804	
Shuma totale	4,950,056	784,810	157,340	898,811	3,109,095

Propozojmë miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë 942,150 lekë për 1 (një) punonjës të planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2026 – 2028, për pozicionin Koordinator të projektit. Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori. Punonjësi do të angazhohet me kohë të plotë (100%), për një periudhë prej 10 muajsh, të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.

Emertimi	Punonjës	Arsim i lartë		Arsim i mesëm
		Grupi i diplomimit	Kategori	Klasa

Përgjegjës (Koordinator lokal të projektit – 10 muaj të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.)	1		III-2	
---	---	--	-------	--

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të ndjekë të gjitha procedurat për rimbursimin e vlerës së TVSH pranë SASPAC – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës.

Sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin AC141 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural”.

KRYETAR

Benet BECI

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

[Signature]

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

[Signature]

Drejtorja e Turizmit

[Signature]



Nr. 28	P.AC141.Q3.O1.A15. Projekti Lake Care	AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural"
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Projekti Lake Care synon restaurimin dhe përmirësimin e vlerave mjedisore, sociale dhe ekonomike të Liqenit të Shkodrës përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, komunitetit lokal dhe palëve të interesit, duke përdorur metodologjinë 4 Returns dhe zgjidhje të bazuara në natyrë (NBS). Metodologjia synon që projektet të krijojnë jo vetëm fitim financiar por katër lloje kthimesh (returns): rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komunitetit, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve lokalë, restaurimin e kapitalit natyror dhe krijimin e përfitimeve ekonomike të qëndrueshme. Projekti do të zbatohet në katër faza kryesore. Në fazën e parë do të identifikohen dhe angazhohen palët e interesit, do të krijohet Komuniteti i Praktikës (CoP) dhe do të nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim. Në fazën e dytë do të hartohet raporti bazë mbi gjendjen e Liqenit të Shkodrës, duke analizuar cilësinë e ujit, gjendjen e habitateve dhe potencialin për zhvillimin e ekoturizmit. Në fazën e tretë do të përgatitet udhërrëfyesi i veprimeve, i cili do të përcaktojë masat prioritare për restaurimin e ekosistemit, përmirësimin e cilësisë së ujit, zhvillimin e shtigjeve ekologjike dhe promovimin e biodiversitetit. Në fazën e katërt do të zbatohen ndërhyrjet pilot, të cilat përfshijnë aplikimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NbS) në rreth 300 m² të brigjeve të liqenit, ndërtimin e dy platformave për vëzhgimin e shpendëve, zhvillimin e 2 km shtigjeve ekologjike dhe monitorimin e ndikimit të këtyre ndërhyrjeve në cilësinë e ujit, biodiversitet dhe zhvillimin e ekoturizmit. Në përfundim, do të organizohet një panair komunitar për promovimin e rezultateve të projektit, ndërhyrjeve të bazuara në natyrë (NBS) dhe produkteve lokale, duke rritur përfshirjen e komunitetit dhe promovimin e ekonomisë lokale. Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy kështe: 80% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Bashkia Shkodër si Partneri Lider dhe 20% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër merr përsipër të parashikojë në kërkesat buxhetore të PBA 2026–2028 shumën prej 988,127 lekë, që përfaqëson kështu në dytë prej 20% të vlerës prej 52,540 euro e konvertuar në 4,950,056 lekë, pa përfshirë vlerën e transfertës për ETMI. Në momentin e miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të rimburohet. <i>Për vitin 2027 Bashkia Shkodër do të paraфинancojë shumën 560,202 lekë</i> <i>Për vitin 2028 Bashkia Shkodër do të paraфинancojë shumën 428,490 lekë</i> Gjithashtu Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma 655,737 lekë për shpenzime operative si dhe shpenzimeve kapitale. Për vitin 2026, detyrimi i TVSH-së, në vlerën 1,131 lekë, do të mbulohet nga tepricat e fondeve të programit buxhetor AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural", sipas fishës <i>PAC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale</i>, nën aktiviteti <i>A.1 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale</i>. Kjo për faktin se, për këtë fishë, më datë 27.08.2026 është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik dhe, pas angazhimit të fondeve për realizimin e kontratës, rezultojnë një teprice fondeve të disponueshme.		
ii. Synimi i projektit		
Synimi i projektit është të krijojë një model bashkëpunimi afatgjatë për menaxhimin e qëndrueshëm të Liqenit të Shkodrës, duke kombinuar mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e ekoturizmit dhe fuqizimin e komunitetit lokal.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Identifikimi i aktorëve kryesorë që lidhen me Liqenin e Shkodrës. - Organizimi i workshop-it dyditor dhe krijimi i Community of Practice (CoP). - Hartimi i raportit bazë mbi gjendjen aktuale të liqenit. - Përgatitja e planit të veprimit me masa konkrete për restaurimin dhe menaxhimin e liqenit. - Zbatimi i ndërhyrjeve pilote përmes zgjidhjeve të bazuara në natyrë: restaurimi i 300 m² zonash përgjatë liqenit; ndërtimi i platformave për vëzhgimin e shpendëve; krijimi i 2 km shtigjeve ekologjike.		

• Monitorimi i rezultateve pas ndërhyrjeve. • Organizimi i një panairi komunitar për promovimin e ndërhyrjeve dhe produkteve lokale.								
b) Rezultatet që prisni								
- Përmirësimi i monitorimit të cilësisë së ujit dhe mbledhja e të dhënave të standardizuara. - Restaurimi i habitateve natyrore dhe përmirësimi i biodiversitetit. - Zhvillimi i infrastrukturës së ekoturizmit përmes shtigjeve ekologjike dhe platformave të vëzhgimit të shpendëve. - Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional. - Krijimi i një modeli të riprodhueshëm për restaurimin e liqeneve në kuadër të programit EuroLakes.								
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)				
- Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura. - Universiteti i Shkodrës. - Organizatat mjedisore dhe shoqëria civile.				- Operatorët turistikë - Komuniteti lokal dhe banorët e zonës së Liqenit të Shkodrës				
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))								
				Nga kjo				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (10 muaj të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.) (donatori)	188,430		156,962	31,468			
A.2	Udhëtime (donatori)	5653				5653		
A.3	Ekspert për biodiversitetin (donatori)	60769				60769		
A.4	Ekspert për financën (donatori)	36461				36461		
A.5	Ekspert për çështjet sociale dhe kulturore (donatori)	36461				36461		
A.6	Ekspert për zgjidhjet e bazuara ne natyre (donatori)	36461				36461		
A.7	Transfertë tek nënkontraktori (donatori)	1,692,855					1,692,855	
A.8	Përmbyllja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë).	1,131				1,131		
	Shuma 2026	2,058,221		156,962	31,468	176,936	1,692,855	0
				Nga kjo				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (10 muaj të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.) (donatori)	471,075		392,405	78,670			
A.2	Udhëtime (donatori + bashkia)	146,975				146,975		
A.3	Blerje e dy çantave portative me sonda për monitorimin dhe matjen e cilësisë së ujit (donatori)	753,720						753,720
A.4	Rikualifikim i bregut perendimor të Liqenit të Shkodrës (Zgjidhje të bazuara në natyrë për cilësinë e ujit (500 m²). (donatori)	1,413,225						1,413,225

A.5	Hapja e shtigjeve të reja ekologjike përgjatë Liqenit të Shkodrës (donatori)	376,860					376,860
A.6	Ndërtimi i platformave vëzhgimore për shikimin e shpendëve. (donatori)	565,290					565,290
A.7	Ekspert për biodiversitetin (donatori + bashkia)	121,537			121,537		
A.8	Ekspert për financën (donatori + bashkia)	97,230			97,230		
A.9	Ekspert për çështjet sociale dhe kulturore (donator + bashkia)	97,230			97,230		
A.10	Ekspert për zgjidhjet e bazuara në natyrë (donatori + bashkia)	97,230			97,230		
A.11	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë).	651,214			29,395		621,819
	Shuma 2027	4,791,586	392,405	78,670	589,597	0	3,730,914
			Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (10 muaj të shpërndarë përgjatë periudhës 24-mujore të zbatimit të projektit.) (donatori + bashkia)	282,645	235,443	47,202			
A.2	Udhëtime (donatori)	16,959			16,959		
A.3	Ekspert për financën (donatori + bashkia)	48,615			48,615		
A.4	Ekspert për çështjet sociale dhe kulturore (donatori + bashkia)	48,615			48,615		
A.5	Ekspert për zgjidhjet e bazuara në natyrë (donatori + bashkia)	48,615			48,615		
A.6	Transferte tek nënkontraktori (donatori)	423,214				423,214	
A.7	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë).	3,392			3,392		
	Shuma 2028	872,055	235,443	47,202	166,196	423,214	0
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik Drejtorja e Turizmit Drejtorja e Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				